

Tiranë, me 20 Prill 2010

**KËRKESË PUBLIKE LIDHUR ME ZHVILLIMIN E TURIZMIT
DREJTUAR
ZOTIT JOHN L. WITHERS II, AMASADOR I SHBA NË SHQIPËRI
Nga kryesia e Shoqatës “Bregdeti”**

I nderuar zoti Ambasador,

Të nxitur nga fakti se ju zoti Ambasador, dy ditë më parë kërkuat promovimin dhe zvillimin e turizmit në Shqipëri, duke vlerësuar impenjimin tuaj për të futur politikën shqiptare në rrugën e demokracisë, si dhe faktin se para pak javësh së bashku me ambasadorin e Gjermanisë, shkuaat në qytetin e Lezhës ku u interesuat për një nga pjestarët e emisionit Big Brother, Kryesia e Shoqatës Bregdeti, ju drejtojmë këtë kërkesë publike nëpërmjet medias së lirë dhe demokratike.

Ne pronarët autoktonë të zonës turistike, prej disa vjetësh po ankohemi se Qeveria shqiptare akoma nuk na ka kthyer me ligj pronën që na mori pa të drejtë sistemi komunist, pra shkel të drejtën e pronës së trashëguar. Kudo prona e trashëguar vlerësohet si gur themelor në sistemin demokratik. Ne e kemi humbur besimin në drejtësinë dhe në politikën shqiptare që me pronat po manipulon vazhdimisht për përfitime personale, elektorale dhe klanore. Për probleme të pronës pas viteve 1994 e deri sot raportohen mbi 2000 krime. **Ne bregdetasit nuk dëshirojmë të marrim me dhunë pronën tonë, por nuk do të nënështrohemi grabitjes së organizuar nga politikanët pasi prona e trashëguar është një e drejtë që na është shkelur që prej kohës kur u vendos diktatura komuniste. Me ligjet aktuale shqiptarët shtyhen të vriten ndërmjet tyre, pasi nxiten të pushtojnë dhe të përfitojnë padrejtësisht pronat e njëri tjetrit. Kjo siç kemi deklaruar publikisht edhe me parë është një lloj genocidi i pa shpallur.**

Ne pronarët e zonës turistike të bregdetit, dëshirojmë më shumë se kushdo promovimin dhe zhvillimin e turizmit në nivelet optimale të idustrisë turistike dhe ju falenderojmë për sygjerrimin tuaj, për zhvillimin e turizmit, por pa kthyer pronën tek i zoti, përpjekjet për zhvillimin e turizmit krijojnë kushte që duke shpërdoruar emrin e SHBA dhe të parimeve bazë të demokracisë, favorizojnë grabitjen e pronave tona nga politikanët.

Si përfaqësues i SHBA që shprehni politikën e Departamentit Amerikan të Shtetit, kryesia e Shoqatës Bregdeti dhe e Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”, nëpërmjet disa kërkesave në vijim, ju kemi kërkuar që të ndikoni që edhe në zonën turistike Vlorë-Sarandë, Qeveria Shqiptare të detyrohet të kthejë pronën tek i zoti ashtu siç është bërë në zonat veriore të Shqipërisë dhe në afro 75% të vendit. Në zonat turistike politikanët shqiptarë po zbatojnë me konsekuencë një stadard tjetër. Ligjet aktuale përfshi dhe ligjet e fundit që ka miratuar dhe zbaton Qeveria Shqiptare për pronat, synojnë që të mbajnë pezull procesin e kthimit fizik tek pronari i shpronësuar nga diktatura dhe toka turistike të përvetësohet nga oligarkia politike.

Nëse do të ishin zbatuar Dispozitat Kryesore Kushtetuese pronat në zonën turistike duhet të ishin kthyer tek i zoti që në 1991. Nëse do të zbatohet neni 41 dhe 181 i Kushtetutës kthimi fizik i pronës duhet të jetë kusht paraprak që të zhvillohet turizmi.

Ne kemi kërkuar dhe kërkojmë që Shteti të jetë i detyruar të kthejë tek i zoti pronën e grabitur dhe të menaxhojë sipas Kushtetutes ato prona që janë të shtetit. Prona që nuk është e shtetit por që është e grabitur nga shteti i diktaturës ligjërisht dhe moralisht duhet të kthehet fizikisht tek pronari i ligjshëm nga vetë shteti demokratik , por shteti po miraton ligje që artificialisht ta pengojë sa më shumë këtë proces .

Nëpërmjet kësaj letre publike kryesia e shoqatës Bregdeti i drejtohet përsëri vemendjes tuaj për të kërkuar ndërhyrjen tuaj për të futur politikën dhe qeverinë shqiptare në rrugën e demokracisë.

E drejta e pronës private dhe transferimi i saj, respektohet nga Kushtetuta Amerikane, respektohet në shkrimet e shenjta Bibla dhe Kurani dhe në Shqipëri ajo është respektuar me rigozitet në traditën tonë zakonore dhe juridikisht me ligje të shkruara është zbatuar që nga mesjeta.

Siç jeni në dijeni nga shkrime të mëparshme mbi **Statutet ose Kushtetutën e Shkodrës**, të vitit 1310, (të përkthyer nga publikimet italiane nga z.Pëllumb Xhufi dhe të botuara në vitin 2003), vërtetohet se e drejta e pronës ka qenë e mbrojtur dhe respektuar, njëllon siç respektohet edhe sot në vendet e zhvilluara demokratike. Nëse krahasojmë qëndrimin ndaj pronës në shekullin XIV dhe sot, kuptojmë se populli shqiptar sot është i drejtuar më keq se në fillim të shekullit XIV. Si argument paraqisim disa nga nenet e kësaj kushtetute 700 vjecare.

“Mbi personat që nuk njohin normat statutore” në kreun 5 të Statutit mesjetar thuhet: “Nëse një qytetar ose i huaj kërkon të justifikohet, duke thënë se nuk i njeh dispozitat e Statutit, justifikimi të mos merret parasysh dhe personi në fjalë duhet të shlyej dënimin sipas fajit” (pra mosnjohja e ligjit nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia)

Në nenet e tjera parashikohet kthimi i gjësë së vjedhur si dhe gjobitja e grabitësit

“Mbi ndërtimin e shtëpisë” në kreun 8 thuhet: “Nëse dikush do të ndërtojë shtëpi me gur apo me dru në një vend ku nuk ka pasur ndërtesë me pare, së pari duhet të thërrasë gjykatësit dhe duhet të rrethojë vendinNëse nuk i fillon punimet detyrohet të paguaj gjobë duke humbur dhe truallin. Këto akte duhet të kryhen me akte të noterit.

“Mbi themelet”, në kreun 14 thuhet: “Nëse dikush gjen themele shtëpie ose shkallë brenda territorit dhe kufijve të vet, ato konsiderohen pronë e tij”.

“Mbi hedhjen e themeleve” në kreun 16 thuhet: “Nëse dikush kapet natën apo ditën duke hedhur themele të paligjshme shtëpie ose shkallë dhe nëse kjo provohet me dëshmi të ligjshme, kundravajtësi gjobitet ... gjoba ndahet përgjysëm midis Kontit dhe paditësit.

“Mbi pretendimet për pronë ose gjëkafshë tjetër”, në kreun 124 thuhet; “Nëse një qytetar i yni apo i huaj, nëpërmjet gjykatësve ngrre pretendim mbi një pronë a gjëkafshë tjetër dhe nëse pala paraqitet në ballafaqim por nuk arrin të paraqesë prova, atëherë gjykatësit duhet ta zhveshi këtë nga prona apo gjëja e kontestuar me një vendim të pakthyeshëm” Ligjet aktuale të pronave perfshi dhe ato që u miratuan nën kujdesin e OSBE në 2004 e shkelen nënin 41 dhe 181 të kushtetutës dhe në aneksin e tyre mbajnë në fuqi ligjin 7501 dhe mbrojnë anarkinë e titujve të pronësisë.

“Mbi të drejtën e pronës, mbi shtëpinë, shkallaren, hajatin, vreshtën, bahçen, ullishten, lajthishten e të tjera” në kreun 149, thuhet: “Cilido person që qysh prej 40 vjetësh zotëron një pronë të patundshme si shtëpi, hajat, shkallare me themel, arë, vreshtë, bahçe, ullishte, lajthishte, e çdo tokë tjetër dhe në rast se gjatë gjithë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë pretendim ndaj këtyre pronave, atëherë këto konsiderohen pronë e tij e përjetshme.

“Mbi ata që përvetësojnë pa vendim gjykatë” në kreun 157 thuhet: “Askush nuk ka të drejtë të përvetësojë me forcë, pa vendime gjykatë, gjënë e tjetrit, qoftë kjo pronë e tundëshme apo e patundëshme. Nëse veprohet kështu, konsiderohet si e pavlefshme edhe të gjitha pronat që vërtetojnë të drejtat e tij mbi këto prona dhe ai humb çështjen. Përveç kësaj detyrohet të paguaj shtatë grosh gjobë dhe në këtë mënyrë çdo njeri të mësojë të sillt” (Ky nen kërkon që e drejta të rrealizohet nëpërmjet gjykatës dhe jo me forcë ose vetgjyqësi, apo me vullnete politike sic është rasti i ynë. Vendimin gjyqësor dhe aktin noterial e parashikon edhe kodi ynë penal por si Kodi Penal dhe Kushtetuta shkelen nga vetë shteti ... Shteti i sotëm legalizon ndërtimin pa leje dhe pronari i truallit do të shpërblehet me një çmim qeshatak me një procedurë që nuk mbaron as pas 50 brezash. Pra vazhdon dhuna e shtetit mbi pronën private)

“Mbi përkrahjen e grabitësit” në kreun 223 thuhet: “ fshatrat dhe katundet që ndodhen rreth qytetit të Shkodrës nuk duhet të mbajnë brenda tyre vjedhës që mund të jenë zënë një ose dy herë në faj. Nëse veprohet ndryshe, fshati ose katundi në fjalë duhet të paguajë 25 hyperperë gjobë, gjysëm e sasisë komunës dhe gjysmën Kontit. Përveç kësaj fshati duhet të paguaj të gjitha vjedhjet që kanë mbetur pa u verifikuar. Si provë vlen pikërisht fakti që fshati këmbëngul që të

mbajë në gjirin e tij grabitësit në fjalë.” Pra drejtësia shqiptare e mesjetës veç përgjegjësisë individuale parashikonte me mënyrën e saj edhe përgjegjësinë kolektive.

Prej vitit 1991, kur Shqipëria u shpall shteti demokratik, detyrimet Kushtetuese sanksionuan zbatimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të konventave ndërkombëtare. Por kanë kaluar 19 vjet që zbatohen ligje me të cilat shkelet e drejta e pronës private. Nëse ju si Ambasador i SHBA ose zëdhënës i politikës së SHBA kërkoni promovimin dhe zhvillimin e turizmit pa përmendur se më parë duhet kthyer prona tek i zoti, kjo favorizon strategjinë e politikës që synon grabitjen e pronave tona që siç jeni në dijeni është tepër flagrante në zonën turistike Vlorë - Sarandë.

Politikanët shqiptarë që pas vitit 1991 me qëllim përvetësimi, kanë krijuar anarkinë me pronat kanë miratuar dhe vazhdojnë të miratojnë ligje që e konsiderojnë pronën tonë si pronë në dispozicion të oligarkisë politike. Atyre nuk ju intereson të bëjnë ligje që përputhen me respektimin e të drejtës së pronës dhe korigjimin e gabimeve por mbrojnë platformën e kompensimit.

Ne kërkojmë kthimin fizik të pronës tek i zoti dhe sipas rastit kompensimin e pseudopronarëve që janë krijuar në mënyrë artificiale. **Prej vitesh mafia politike e pronave e komandon pushtetin. Legjislacioni për pronën është në shkelje të hapur të asaj që parashikon Kushtetuta.** Mos kthimi i pronës tek i zoti nuk është shpronësim për nevoja publike dhe në aspektin praktik është mashtrim fund e krye. Këtë politikë ne e kemi denoncuar si antikombëtare pasi e fut shtetin në krizë të vazhdushme sociale dhe ekonomike. Kompensimi që parashikojnë ligjet aktuale është antikushtetues, është barrë që u ngarkohet të gjithë taksapaguesve shqiptarë dhe nuk mund të realizohet as pas 1000 vjetësh. Kjo platformë e anarkisë së titujve të pronësisë, praktikisht është sabotim i themeleve të demokracisë.

Këtë problem të popullit dhe të demokracisë shqiptare ne ja kemi relatuar edhe këshilltarit politik të ambasadës së SHBA. **Ju lutemi që ky problem të transmetohet Presidentit të SHBA dhe sektorit përkatës të politikës në Departamentin e Shtetit, pasi kjo politikë e gabuar nuk duhet të mashtrojë për më shumë kohë instancat ndërkombëtare të BE, KE dhe USA.**

I nderuar zoti Ambasador, ne jemi shume te interesuar për nje takim sqarues me ju.

Ne shpresojmë në mirkuptimin dhe impenjimin tuaj që nëpërmjet Departamentit Amerikan të Shtetit, të ndikoni në zgjidhjen e shpejtë të këtij problemi jetik për popullatën autoktone të zonës turistike Vlorë – Sarandë.